



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

**Anr.468/2025**

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më datë 11.02.2025, merr këtë:

### **V E N D I M**

- I. Pranohet e bazuar ankesa e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, Anr.468/2025 e datës 09.02.2025.
- II. Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 500, (pesëqind) €uro.
- III. Detyrohet Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

### **A r s y e t i m**

Me datën 09.02.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në të cilën pretendon se me 8 Shkurt 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Istog ka identifikuar ngjitës (stickerë) të kandidatëve për deputetë të LDK-së, Xhafer Tahiri dhe Lumir Abdixhiku, të shoqëruara me numrin me të cilin kandidon në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Këta ngjitës (sticker) janë të ngjitura në kuti të energjisë elektrike dhe në shtyllat ndriçuese në rrugën publike "Nëna Terezë" në Istog.

Me këtë veprim kandidatët dhe subjekti politik LDK kanë bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës

Në përgjigjen në ankesë të Subjektit Politik LDK, theksohet se pretendimi se kandidati për deputet Xhafer Tahiri ka shkelur nenin 34 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit për

Zgjedhjet e Përgjithshme konsiderojmë se ligjërisht nuk qëndron, ngase fillimisht pretendimi ankimor ka të bëjë me një sticker (foto e vogël ngjitëse për telefon mobil), e cila nuk është vendos fare nga kandidati e as mbështetësit e tij, sepse i njëjti vjen si kandidat nga një qytet krejt tjetër (Vushtrria), pastaj stickeri i ngjitur nga kushdo qoftë nëse analizohet në përmbajtje, nuk ka llogo të partisë (Lidhjes Demokratike të Kosovës), nuk ka thirrje për votim të LDK-se, pra është krejtësisht jashtë elementeve me përmbajtje zgjedhore, dhe për me tepër një kandidat nga Vushtrria qofte vet ai apo mbështetësit e tij me e marr rrugën Vushtrri-Istog me i vendos 3 stickersa që kushtojnë jo me shumë se 1 euro të tre bashke, është nonsens dhe pa asnjë logjike.

Andaj, ankuesi nuk e ka provuar faktin se kush i ka vendosur ata stickera, dëshmitë e tilla nuk janë as bindëse e as faktike për PZAP, madje ne asnjë postim gjate krejt fushatës zgjedhore në rrjetin social facebook apo instagram nuk gjen një sticker-fotot të tilla të kandidatit Xhafer Tahiri bashke me kryetarin e partisë z. Lumir Abdixhiku, në ndonjërin prej rrjeteve sociale të njëjtëve.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se :

**-Ankesa është e bazuar.**

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje, janë të bazuara dhe si të tilla i aprovoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”*

Në përgjigje të ankesës, ku kundërshtohet pretendimi ankimor, theksohet se ngjitësit (stickerët) nuk janë vendosur nga kandidati ose mbështetësit e tij, pasi ai është kandidat nga një qytet tjetër (Vushtrria). Gjithashtu, stickeri i ngjitur nga kushdo qoftë, nëse analizohen elementët e tij, nuk ka logon e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), nuk ka thirrje për votim për LDK-në, dhe është krejtësisht jashtë kontekstit të fushatës zgjedhore,

Megjithatë, duke u bazuar në provat e paraqitura, paneli ka vlerësuar se nga mbështetës të subjektit politik LDK janë vendosur ngjitës (stickerë) për kandidatët e saj për deputetë, Xhafer Tahiri dhe Lumir Abdixhiku, në shtyllat ndriçuese dhe kutitë e energjisë elektrike në rrugët publike. Këto ngjitëse ishin të shoqëruara me numrin me të cilin kandidonin kandidatet. Paneli ka konsideruar këtë veprim si shkelje të nenit 34, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, pasi veprimi është bërë në hapësira publike dhe ka përmbajtje që lidhet me aktivitetet zgjedhore.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet në ankesë janë të qëndrueshme dhe si të tilla i pranoi, sepse kjo shkelje ka të

bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e pranoi si të bazuar.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e lehte të shkeljes si dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë. Kjo konsiston në faktin se Subjekti Politik LDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paraf 1.3 të LZP-së, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.468/2025 datë 11.02.2025

**Kryesuese e Panelit**  
**Kymete Iscaj**



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së.